



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

NJOFTIM

Njoftojmë të interesuarit që duan të aplikojnë për të ndjekur studimet e lartë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, se fillimisht ata duhet të ndjekin procedurën e njohjes dhe njësimit të diplomës së arsimit të mesëm të lartë të fituar jashtë vendit, në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.

Për tu informuar për procedurën që duhet ndjekur, aplikantët duhet të njihen me udhëzimin nr.13, datë 30.06.2023, *“Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”*, duke klikuar në këtë adresë.

<https://qsha.gov.al/wp-content/uploads/2024/06/udhezim-njesim-diplome.pdf>

Formulari që duhet plotësuar dhe dorëzuar bashkë me dokumentacionin mund ta shkarkoni këtu:

<https://qsha.gov.al/wp-content/uploads/2024/06/njesim-arsimi-mesem.pdf>

Aplikimi për njohjen dhe njësimin e diplomës së arsimit të mesëm të lartë, që i përket nivelit 4 të Kornizës Shqiptare dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, kryhet duke dërguar dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. diplomën e arsimit të mesëm të lartë ose dokumentin zyrtar përkatës të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve të arsimit të mesëm të lartë, të pajisur me vulë apostile ose legalizim nga vendi i lëshimit, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë,
- ii. dëftesat e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, të pajisur me vulë apostile ose legalizim nga vendi i lëshimit, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë,
- iii. dokumentin që vërteton se ka dhënë provime kombëtare të njëvlershme me ato të Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë, të pajisur me vulë apostile ose legalizim nga vendi i lëshimit, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë,
- iv. fotokopjen e dokumentit të identifikimit.

Informojmë se në bazë të udhëzimit të mësipërm aplikimi kryhet online, **por deri në funksionimin e plotë të sistemit online, aplikimi do të kryhet vetëm në formë shkresore me postë zyrtare.**

Ky shërbim është pa pagesë.

Adresa postare: Qendra e Shërbimeve Arsimore. Bulevardi: Zhan D'Ark, nr. 23, Tiranë.

Për më shumë informacion, vizitoni faqen zyrtare: www.qsha.gov.al

Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 23, Tiranë

Web site: www.qsha.gov.al